

DITA E PARË: 17 MAJ 2018 | Hapja e Konferencës Diaspora Flet

Procesi i regjistrimit

17:00-18:30 **Lokacioni:** Amfiteatri i ri, Biblioteka Qendrore e Universitetit *Hasan Prishtina*

Regjistrimi dhe akreditimi i pjesëmarrësve në hapje të konferencës: Ju do të pajiseni me materiale të nevojshme të konferencës: programin dhe informacione përkatëse për konferencën, kartelë identifikuese, si dhe udhëzime për qytetin e Prishtinës.

Hapja e Konferencës

18:30-19:00 **Lokacioni:** Amfiteatri i ri, Biblioteka Qendrore e Universitetit *Hasan Prishtina*

Fjalë hyrëse nga organizatorët dhe folësit kryesor:

- **Fjalë përshëndetëse:** Liza Gashi, Drejtoreshë e Programeve, Germin
- **Fjalimi kryesor :** Kingsley Aikins, Themeluesi i *Diaspora Matters*, Republika e Irlandës

Paneli ndër-ministror: Drejt një kontrate shoqërore ndërmjet diasporës dhe vendeve të tyre të origjinës

19:00-20:30 **Lokacioni:** Amfiteatri i ri, Bibloteka Universitare (ish-Instituti i Historisë), në Prishtinë

Synimi kryesor i panelit ndër-ministror është vendosja e qëllimeve kryesore për angazhimin e diasporës në atdhe, bashkëpunimet ndër-shtetërore dhe planet e angazhimit në të ardhmen për shfrytëzimin e potencialit të diasporës drejt zhvillimit të Ballkanit Perëndimor. Ky panel do të paraqes edhe parimet e politikat kryesore drejt angazhimit të diasporës nga secila Qeveri.

- **Dardan Gashi**, Zëvendëskryeministër dhe Ministër i Diasporës, Qeveria e Republikës së Kosovës
- **Pandeli Majko**, Ministër i Shtetit për Diasporën, Qeveria e Republikës së Shqipërisë
- **Edmond Ademi**, Ministër për Marrëdhëniet me Diasporën, Qeveria e Republikës së Maqedonisë

Moderatore: Liza Gashi - Drejtoreshë e Programeve, Germin

20:30-21:30 **Koktej rasti dhe shfaqje artistike**

DITA E DYTË: 18 MAJ 2018 | *Diaspora Flet* në Kuvendin e Kosovës

Regjistrimi për ditën: *Diaspora Flet* në Kuvend

9:00 – 9:45 **Lokacioni:** Holli i Kuvendit të Kosovës

Mysafirët regjistrohen në hyrjen të Kuvendit të Kosovës (hyrja prapa objektit të komunës së Prishtinës). Ju do të merrni çantën me informatat kryesore dhe një dhuratë simbolike nga Kuvendi i Kosovës. Për shkaqe sigurie, të gjithë mysafirët duhen t'i nënshtrohen kontrollit për metale dhe po ashtu do të kontrollohen çantat e tyre.

Diaspora Flet në Kuvendin e Kosovës

9:45 –11:30 **Lokacioni:** Salla Plenare, Kuvendi i Kosovës

Fotografi: Fotografi e përbashkët me anëtarët e Kuvendit dhe profesionistët nga Diaspora

Fjalim hyrës: **Kadri Veseli**, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Fjalim hyrës: **Behar Xharra**, Drejtor Ekzekutiv, Germin

Fjalime hyrëse nga [udhëheqësit e grupeve parlamentare](#) të partive politike në Kuvendin e Kosovës

Fjalime hyrëse nga 6 pjesëmarrës nga Diaspora:

1. **Brikena Muharremi**, avokate dhe anëtare e bordit të Germin, si dhe udhëheqëse e Shoqatës së Avokatëve Shqiptaro-Britanik, Londër, Britani e Madhe (Qasja Institucionale për të Drejtën e Votës);
2. **Richard Lukaj**, Drejtor Ekzekutiv, Bank Street Group, Konsull nderi për Shqipërinë dhe anëtar i Bordit të Universitetit Amerikan në Kosovë, New York, SHBA (Investimet Strategjike dhe Edukimi);
3. **Lazim Destani**, Drejtor Gjeneral i Ecolog International (Filantropia dhe Investimet kapitale);
4. **Mark Kosmo**, anëtar i bordit të Germin dhe udhëheqës i Shoqata Shqiptaro-Amerikane e Massachusetts *BESA*, Boston, SHBA (Angazhimi i Diasporës, roli Institucional dhe Filantropia);
5. **Indira Kartallozi**, Kaleidoscope Futures Lab, anëtare e Bordit të Germin, Antwerp, Belgjikë (Ndërmarrësia dhe Ndërmarrjet shoqërore);
6. **Hilmi Gashi**, anëtar i bordit të Germin, bashkëkryesues i *UNIA* për Rajonin Berner Oberland, Bern, Zvicër (Migrimi qarkor dhe transferimi i njohurive);
7. **Lulzim Sylja**, Elen Group, NRW, Gjermani (Politikat Ekonomike dhe Zhvillimi Lokal);

Kjo mbledhje do të jetë e hapur për mediat dhe do të transmetohet drejtpërdrejt në Radio Televizionin Publik - RTK.

11:30-12:55 **Drekë në hollin e Kuvendit, shtruar nga Kuvendi i Kosovës**

Sesionet e punës me komisionet e zgjedhura parlamentare

13:00-15:00 | *Diaspora Flet* me komisionet e zgjedhura të Kuvendit në katër fushat primare të interesit

Pas përfundimit të mbledhjes kushtuar diasporës, pjesëmarrësit e konferencës (11-15 persona) do të jenë pjesë e katër mbledhjeve në komisionet parlamentare të Kuvendit të Kosovës. Anëtarët profesionistë të Task Forcave, të formuar dhe menaxhuar nga Germin, do të angazhohen drejtëpërdrejt dhe së bashku me deputetët e komisioneve parlamentare në adresimin e temave kryesore të diasporës që lidhen me të drejtat politike, shoqërore dhe ekonomike. Këto sesione do të organizohen nga komisionet parlamentare dhe do të jenë të përqendruara dhe kanalizuar në fushat kryesore e të interesit për diasporën, të identifikuar gjatë 11 grupeve të fokusit me anëtarët e diasporës në Evropë dhe ShBA. Gjatë sesioneve, pjesëmarrësit nga diaspora do të kenë mundësinë që të njoftohen dhe avokojnë direkt në agjendat e deputetëve në temat e caktuara të interesit.

Paraprkishtë, pjesëmarrësit duhet të regjistrohen për njërin nga katër sesionet, por prioritet do të kenë pjesëtarët e shtatë Task Forcave.

<p>Tema: Politikat kryesore të dala nga nevojat e diasporës përgjatë implementimit të nismës Dialogu i Strukturuar për të Drejtat e Diasporës.</p>	<p>Tema: Mësimi plotësues jashtë vendit, Qendrat Kulturore dhe Shkëmbimi Profesional me Diasporën.</p>	<p>Tema: Korniza institucionale dhe ligjore, përfaqësimi i diasporës dhe e drejta për votë.</p>	<p>Tema: Politikat Ekonomike, promovimi i projekteve lokale dhe regjionale për zhvillim.</p>
<p>Komisioni: Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike</p>	<p>Komisioni: Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi</p>	<p>Komisioni: Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit</p>	<p>Komisioni: Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal</p>

<p>Liderët e Task Forcave:</p> <p>Hilmi Gashi, UNIA, Zvicër Jetmir Bakija, Demokraci +, Kosovë Selam Hajrizi, Francë</p> <p>Rendi i ditës:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Hyrje dhe prezantim 2. Analiza të politikave kryesore për avokim 3. Të gjeturat kryesore nga Germin 4. Planet e Veprimit nga Task Forcat 	<p>Liderët e Task Forcave:</p> <p>Indira Kartallozi, Kaleidoscope Futures Lab, Belgjikë Bashkim Mehulli, UraCult e.V., Gjermani</p> <p>Rendi i ditës:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Hyrje dhe prezantim 2. Analiza të politikave kryesore për avokim 3. Të gjeturat kryesore nga Germin 4. Planet e Veprimit nga Task Forcat 	<p>Liderët e Task Forcave:</p> <p>Brikena Muharremi, Shoqata e Avokatëve Shqiptaro-Britanik, Mbretëria e Bashkuar Mark Kosmo, Shoqata MAAS BESA, Boston ShBA</p> <p>Rendi i ditës:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Hyrje dhe prezantim 2. Analiza të politikave kryesore për avokim 3. Të gjeturat kryesore nga Germin 4. Planet e Veprimit nga Task Forcat 	<p>Liderët e Task Forcave:</p> <p>Lulzim Sylja, Ellen Group, Gjermani Franceska Gjorga, Massachusetts House of Representatives, ShBA</p> <p>Rendi i ditës:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Hyrje dhe prezantim 2. Analiza të politikave kryesore për avokim 3. Të gjeturat kryesore nga Germin 4. Planet e Veprimit nga Task Forcat
---	---	--	--

Bashkëbisedim me Qeverinë e Republikës së Kosovës

13:00-14:30 | **Diaspora Flet** me Zv.Kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Fatmir Limaj (tbc) në objektin e Qeverisë së Kosovës

Pjesëmarrësitë e *Diaspora Flet* do të priten në takim nga Zv. i Republikës së Kosovës, z. Fatmir Limaj (tbc). Synimi kryesor i këtij takimi është të diskutohet për së afërmi se sa është prioritet diaspora në agjendën e kësaj Qeverie, duke përfshirë edhe zbatimin e strategjisë dhe planit për zhvillim të qëndrueshëm kombëtar 2016-2021. Njëherazi ky takim do të shërbejë si hapësirë ku pjesëtarët e Diasporës kanë mundësi të ndërtojnë lidhje komunikimi me Qeverinë aktuale të Republikës së Kosovës.

Paraprkishtë, ju duhet të regjistroheshi për këtë sesion në ditën e parë të regjistrimit.

Roli i Diasporës për zhvillimin e ndërmarrësisë dhe shkëmbimi i shkathtësive

15:30 - 17:00 | **Lokacioni:** Kino Armata, rr.Brigada e Kosovës (në afërsi të Hotel Grand, sheshi "Zahir Pajaziti")

Ka mënyra të ndryshme që diaspora të kontribuojë në vendet e tyre, përmes transferimit të njohurive dhe ndërmarrësisë sociale. Qasjet tradicionale janë fokusuar në kthimin e migrantëve për angazhim afatgjatë, kurse qasjet e reja për programet e kthimit të përkohshëm të diasporës po fitojnë gjithnjë e më shumë vëmendje. Në një sondazh të fundit me 1,000 profesionistë të diasporës në Shtetet e Bashkuara, u bë e qartë se preferenca për angazhim afatshkurtër (1-3 javë në vit) me vendet amë ka precedent. Cilat janë disa nga praktikatat më të mira globale për të nxitur njohuritë, aftësitë dhe rrjetet e diasporës për të mbështetur ndërmarrësinë sociale dhe zhvillimin lokal? Si mund

të marrin pjesë institucionet publike në këtë burim të pashfrytëzuar? Cilat janë disa iniciativa aktuale që eksplorojnë angazhimin afatshkurtër të profesionistëve të kualifikuar në Kosovë? Cili mund të jetë roli i shoqërisë civile në këtë drejtim?

Panelistët:

1. **Martin Russell**, MRC, Irlanda;
2. **Xhelal Dërguti**, Koordinator për Programin "Migracioni për Zhvillim", Kosovë/Gjermani
3. **Faik Spahiu**, Drejtor Ekzekutiv në Internews Media; Kosovë
4. **Jeta Xharra**, Drejtoreshë Ekzekutive në BIRN, Kosovë
5. **Vergula Shqevi**, Prizm/Shkolla e Diasporës në Kosovë, Greqi/Shqipëri

Moderatore: Shpresa Loshaj, Këshilltare e Politikave për Departamentin e Inovacionit, Shkencës dhe Zhvillimit Ekonomik në Qeverinë e Kanadasë

[Panel i mbyllur] Punëtori ndërshtetërore mbi të drejtën e punës në Kosovë

15:30 - 17:00 | **Lokacioni:**

Kjo punëtori organizohet në bashkëpunim me sindikalistët shqiptarë nga sindikata [UNIA](#) në Zvicër, të cilët do të trajtojnë të drejtat e punëtoreve dhe aspektin ligjor rreth zbatimin e ligjit të punës, sigurimin shëndetësor dhe aksidental dhe sigurinë sociale në Kosovë. Pjesëmarrësit janë ekspertë të sindikatës *UNIA*, si dhe nga Kryesia e Bashkësisë e Sindikatave të Pavaruara të Kosovës. Po ashtu do të marrin pjesë përfaqësues të degëve sindikalistë, grupet e organizatat tjera që merren me aktivitete sindikaliste si dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile.

Panelistët:

1. **Osman Osmani**, Zvicër;
2. **Ruzhdi Ibrahim**, Zvicër;
3. **Hilmi Gashi**, Zvicër;
4. **Përfaqësues nga Kryesia e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës;**

17:00 - 18:00 Darkë në tavolinë suedeze/koktej, në hapësirat e Kino Armatës

DITA E TRETË: 19 MAJ 2018 | Investimet e Diasporës, Transferimi i Njohurive dhe Filantropia

Rrjetet e Diasporës: Lidhja institucionale me vendin e origjinës

9:00 - 10:30 | **Lokacioni:** Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Arkitekturës, salla *Modelariumi*

Rrjetet e diasporës mund të luajnë një rol kyç në organizimin e grupeve të ndryshme të interesit dhe ndërmarrjeve, dhe po ashtu në revitalizimin e lidhjes së tyre me vendin e origjinës. Në mungesë të kornizave ligjore institucionale të cilat janë efektive, profesionistët nga diaspora dhe rrjetet e biznesit mund të krijojnë mekanizma ndihmës që të kanalizojnë njohuritë, grupin e shkathtësive, investimet, angazhimin në politika dhe filantropi të migrantëve tek vendi i tyre i origjinës. Ky panel do mbledh përfaqësues nga disa rrjete aktive të diasporës në Evropë dhe SHBA, dhe do të zbulojë mënyra efektive të ndikimit në atdhe dhe po ashtu të mbështesë komunitetet lokale në shtetet rezidente ku ata jetojnë.

Panelistë:

1. **Bekim Bestrovci**, Unioni i Bizneseve Shqiptare, Gjermani
2. **Arlind Isufi**, Hérens Quality Asset Management, Zvicër
3. **Artan Llabjani**, Rrjeti i Bizneseve ne Angli
4. **Emira Ajeti**, USAID EMPOWER
5. **Nora Hasani**, Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK)

Moderator: Lulzim Sylja, Elen Group, NWR, Gjermani

Sesioni II/A: Mobilizimi diasporës për zhvillim: teknologjia dhe ndërmarrësia

11:00 -12:30 | **Lokacioni:** Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Arkitekturës, salla *Modelariumi*

Paneli do të përpiqet të analizojë mundësitë që ofron teknologjia për ndërmarrësitë e diasporës për të investuar në atdhe dhe si të përshtaten nevojat e tregut të vendeve ku jetojnë me ofertën e tregut të punës dhe aftësive në vendet amë. Në dekadën e fundit kemi parë plot nisma të suksesshme të diasporës në Kosovë, Shqipëri e Maqedoni që kanë rezultuar në krijimin e vendeve të punës, përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe rritjen e eksportit të shërbimeve dhe mallrave jashtë vendit. Paneli po ashtu do të diskutojë se si diaspora mund të përdorë teknologjinë për të shfrytëzuar mundësitë që ajo ofron për të investuar në vendin e tyre të origjinës. Cilat janë disa nga përmirësimet dhe stimulimet konkrete që qeveritë qendrore dhe ato lokale mund t'u japin ndërmarrjeve të diasporës për të sjellë investime dhe vende të reja pune në atdhe? Si mund ta ndihmojë diasporën teknologjia dhe ndërmarrësia në vendet tona, që të zgjidhin disa nga problemet e tyre në vendet ku jetojnë, p.sh. ofrimin e klasave të gjuhës shqipe, çasje në pakot e ndryshme të pushimeve në

atdhe përmes internetit, blerjen e prodhimeve vendore, madje edhe votimin në internet?

Panelistët:

1. **Valdrin Lluka**, Ministër i Zhvillimit Ekonomik
2. **Flamur Mavraj**, Drejtor Gjeneral i Kompanis Orion, Norvegji
3. **Monika Farka**, Themelues dhe partner menaxhues e Dynamics Partners, Shqipëri
4. **Shqipe Buzuku**, LUT Shkolla e Inxhinierisë Industriale dhe Menaxhimit, Finlandë
5. **Arbër Bullakaj**, Drejtor Gjeneral, A&O Consulting, Zvicër

Moderator: Behar Xharra, themelues dhe drejtor ekzekutiv i Germin, Washington D.C.,

Sesioni II/B: Diaspora: Sa përfshihet ky potencial njerëzor në qytetet shqiptare?

11:00 -12:30 | **Lokacioni:** Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit

Qytetet kudo në botë po bëhen gjithnjë e më tepër shtytëse të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror në shtetin që i përkasin, sidomos tani kur shumica e njerëzve në botë jetojnë në vende urbane. Qytetet kanë asete ekonomike, shoqërore e njerëzore, dhe sukcesi i qyteteve varet nga kujdesi dhe zhvillimi i këtyre aseteve. Sa përfshihen në këtë përllogaritje asetet njerëzore të diasporës? Si po përpiqet Tirana apo Prishtina që të tërheqë njerëzit e saj inovatorë nga Diaspora? A është reale që edhe qytetet e mesme dhe të vogla ta bëjnë një gjë të tillë? Çfarë kërkojnë konkretisht personat nga diaspora para se të sjellin përvojën dhe ekspertizën e tyre në vendin e prejardhjes? Dhe çfarë po bëjnë qytetet në rajon apo përtej, në këtë drejtim?

Panelistët:

1. **Shpend Ahmeti**, Kryetar i Komunës së Prishtinës
2. **Arbjan Maziku**, Nënkryetar i Bashkësisë së Tiranës
3. **Besnik Tahiri**, Ekspert i Qeverisjes Lokale
4. **Shpresa Loshaj**, Këshilltare e Politikave për Departamentin e Inovacionit Shkencës dhe Zhvillimit Ekonomik në Qeverinë e Kanadasë

Moderuar nga **Drilon S. Gashi**, Specialist i Zhvillimit Urban / Konsulent i Lartë - Deloitte U.S. Financial Advisory, Washington D.C.

Sessioni III/A Arsimi dhe Kultura: Drejt një shkëmbimi më gjithëpërfshirës, modern dhe efikas

14:00 -15:30 | **Lokacioni:** Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit

Në dy dekadat e fundit diaspora e ka përqendruar me teper vëmendjen në arsim dhe aktivitete kulturore. Ata kanë kontribuar si profesorë, studiues dhe artistë në qytetet e rëndësishme të shkencës dhe kultures. Ky fokus jo vetëm që ka kontribuar në një përvojë të jashtëzakonshme të diturisë dhe në një përfaqësim më të madh të shteteve amë në qarqet arsimore dhe kulturore jashtë vendit, por gjithashtu ka ofruar mundësi për ndërtimin e lidhjeve me institucionet, universitetet, dhe organizatat botërore. Ky panel do të diskutojë se si shtetet amë mund të shfrytëzojnë përvojën e diasporës dhe lidhjet e krijuara për ofrimin e mundësive të reja arsimore dhe kulturore në vendet amë. Si mund të përfitojnë të rinjtë nga programet shkëmbyese? Si mund ta përdorim teknologjinë në mënyrë efektive për mësim në distancë të largët? Si mundet shkencat, arti, dhe aktivitete kulturore të kontribuojnë në zhvillimin e vendit? Me këto dhe shumë pyetje tjera ne shpresojmë të nxjerrim ide të reja dhe të arritshme.

Panelist:

1. **Mimoza Leka**, Mësuese e mësimin plotësues, Gjermani
2. **Valon Murati**, Ish-Ministër për Diasporën në Republikën e Kosovës
3. **Aneta Mihali Xhiku**, Menaxhere e të Drejtës Intelektuale, Shtetet e Bashkuara të Amerikës
4. **Agon Kamberi**, Shoqata OASA e.V. Gjermani
5. **Petrit Kuçana**, Britani e Madhe

Moderatore: Venera Kusari, Columbia University, New York City

Sesioni III/B Diaspora dhe Integrimet Evropiane

14:00 -15:30 | **Lokacioni:** Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit

Diaspora shqiptare gjithmonë ka luajtur rol kyç kur komuniteti ndërkombëtar ka marrë vendime të rëndësishme për vendet e tyre të origjinës. Integrimi Evropian i Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë e vendeve të tjera në Ballkan janë pikësynime primare shtetërore në vendet respektive. Shtetet e tjera me diasporë të gjërë, gjatë rrugëtimit të tyre drejt integritimeve evropiane e negociatave me Brukselin, kanë bashkëpunuar e koordinuar kokë më kokë çdo veprim të tyre me ekspertët e diasporës së tyre. Diaspora shqiptare ka ekspertët e saj në këtë sferë mirëpo deri më sot, fatkeqësisht, eksperiencat e tyre nuk është shfrytëzuar në nivel të kënaqshëm. Si mund ta ndryshojmë këtë? Për këtë do të diskutojë paneli i përbërë prej:

1. **Vjollca Hajdari**, Politologe, Publiciste dhe Etnologe, në Gjermani
2. **Bahri Troja**, Koordinator për Integrim në Ministrinë e Punëve të Jashtme, në Austri
3. **Nezir Kraki**, Ligjërues i Shkencave Politike në Universitetin Paris Est, në Paris

4. **Megi Mass**, Këshilli i Integritetit - Qytetit i Recklinghausen, në Gjermani

Moderator: Avni Dervishi, Politog dhe ish-deputet në Suedi

Investimi në atdhe: Storit e suksesit të Diasporës

16:00 -17:30 | **Lokacioni:** Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Arkitekturës, salla *Modelariumi*

Një sërë figurash të dala nga diaspora dallohen me projektet e tyre të zhvilluara në Kosovë, sikurse për nga ideja, vizioni, qasja, fusha e veprimit, kultura e punës, po ashtu edhe nga efektet direkte dhe anësore që kanë pasur në zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë dhe ekonomisë kosovare. Cilat janë motivimet e tyre kryesore për t'u angazhuar në Kosovë? A ia vlen të investosh kohë dhe mjete në Kosovë? Cilat kanë qenë pritjet fillestare, por edhe sfidat dhe si i kanë tejkaluar ato? Cilat janë përfitimet personale, por edhe ku qëndron vlera e shtuar shoqërore e projekteve të tyre? Çfarë e dallon një iniciativë nga persona me përvojë nga jashtë, me ato që burojnë nga brenda vendit. Çfarë duhet të ndërmarrin institucionet kosovare me relevancë për të motivuar investime të tjera të ngjashme të diasporës në Kosovë?

Panelistët:

1. **Mërgim Cahani**, Themelues dhe CEO i Kompanisë *Gjirafa Inc.*,
2. **Jehona Gjurgjeala**, Themeluese e Shoqatës *Toka*,
3. **Drenusha Shala**, Bashkëthemeluese e Kompanisë *Baruti*,
4. **Edmond Hajrizi**, Kryetar dhe themelues i Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT)

Moderimi: Bashkim Iseni & Vjosa Gërvalla, drejtues të platformës albinfo.ch

Vizitë kulturore dhe Forumi Diaspora Flet Njëpër Botë

18:30- 20:30 | Lokacioni: Muzeu Kombëtar i Kosovës

Pas paneleve, në Muzeun Kombëtar të Kosovës do të realizohet një vizitë kulturore dhe një bashkëbisedim me profesionistë nga Diaspora. Muzeu i Kosovës përfshinë një koleksion, me më shumë se 50 mijë eksponate të profileve të ndryshme, prej pavijonit të arkeologjisë, teknologjisë, historisë, natyrës, ento-kulturës, folklorit, trashëgimisë, etj. Aktualisht, Muzeu është duke u angazhuar në rikthimin e 1200 objekteve/artefakteve të rëndësishme për trashëgiminë kulturore të Kosovës, të marra nga Beogradi gjatë vitit 1998.

→ Fjalë rasti nga **z. Kujtim Gashi**, Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Forumi Diaspora Flet nëpër Botë

Diaspora shqiptare është e heterogjene. Çdo komunitet që jeton në diasporë përballet me sfida dhe nevoja të ndryshme. Ky është një forum me bisedë të hapur për anëtarët e Diasporës, të cilët do të kenë mundësi të prezantojnë disa nga çështjet dhe sfidat më të rëndësishme që komuniteti i tyre përballet në aspektin e vazhdimësisë së lidhjes me vendin e tyre të origjinës dhe mundësitë që ata shohin në rritjen e rolit të diasporës në fushën e krijimit të politikave dhe zhvillimit ekonomik e social. Ky forum, po ashtu, do të jetë një hapësirë për njohjen e komuniteteve të ndryshme të diasporës shqiptare në mes tyre.

1. **Ermal Sulaj**, Greqi
2. **Muhamet Idrizi**, Gjermani
3. **Ganimete Bajraktari**, Austri
4. **Florim Kadriu**, Zvicër
5. **Bled Maliqi**, Norvegji
6. **Faton Krasniqi**, Finlandë
7. **Heset Ahmeti**, Slloveni
8. **Emidio Tedeschini**, Itali
9. **Velime Qarri**, Gjermani
10. **Konstandin Ristani**, Kanadë
11. **Alban Pruthi**, Shtetet e Bashkuara të Amerikës
12. **Lulzim Veliu**, Bashkësia Shqiptare në Gjermani

Moderatore: Rina Lila, Citibank, Londër, Mbretëria e Bashkuar
Fjolla Vukshinaj, Germin

Darkë, Muzeu Kombëtar

DITA E KATËRT: 20 MAJ 2018 | Angazhimi i Diasporës në Zhvillimin Lokal

Ceremonia përmbyllëse

09:00 -10:30 | **Lokacioni:** Galeria Kombëtare e Arteve

Ceremonia përmbyllëse e Konferencës *Diaspora Flet* mbahet në Galerinë e Arteve të Kosovës (në afërsi të Bibliotekës Kombëtare "Pjetër Bogdani". Gjatë ceremonisë do të organizohet paneli përmbyllës **Diaspora Flet nëpër Botë**, do të diskutohen planet dhe aksionet e ardhshme për avokim kundrejt rolit dhe angazhimit të diasporës në vendet e tyre të origjinës. Ceremonia do të përcillet me një koktej rasti, dhe mysafirët do të kenë rastin të vizitojnë ekspozitën "Mjegull."

Angazhimi i Diasporës në Zhvillimin Lokal | Mitrovicë

11:00 - 15:00 | Nisja për në Komunë bëhet tek Galeria Kombëtare e Arteve

Z. Agim Bahtiri, Kryetari i Komunës së Mitrovicës, do të jetë nikoqir i profesionistëve të diasporës për një bashkëbisedim rreth angazhimit të diasporës në zhvillimin lokal; si dhe për t'u njoftuar rreth strategjive dhe projekteve të kësaj komune për diasporën.

12:10 - 13:15 -- Takim diskutues me Kryetarin e Komunës, z. Agim Bahtiri dhe Nënryetarin, z. Faruk Mujka

13:30 - 14:30 -- Vizitë në teren: Mundësitë dhe sfidat për investime në nivelin lokal

Modeli i Kompanisë *Hirano Mushrooms* ([Kliko këtu](#))

14:30 - 15:30 -- Drekë

15:30 - 16:30 -- Arritja në Prishtinë

Angazhimi i Diasporës në Zhvillimin Lokal | Prizren

11:00 - 15:00 | Nisja për në Komunë bëhet tek Galeria Kombëtare e Arteve

Z. Mytahir Haskuka, Kryetari i Komunës së Prizrenit, do të jetë nikoqir i profesionistëve të diasporës për një bashkëbisedim rreth angazhimit të diasporës në zhvillimin lokal dhe rreth ideve për strategji dhe projekte konkrete të kësaj komune për diasporën.

12:10 - 13:15 -- Takim diskutues me Kryetarin e Komunës, z. Mytahir Haskuka

13:30 - 14:30 -- Vizitë në teren: Mundësitë dhe sfidat për investime në nivelin lokal

14:30 - 15:30 -- Drekë

15:30 - 16:30 -- Arritja në Prishtinë

Angazhimi i Diasporës në Zhvillimin Lokal | Kamenica

11:00 - 15:00 | Nisja për në Komunë bëhet tek Galeria Kombëtare e Arteve

Z. Qëndron Kastrati, Kryetari i Komunës së Kamenicës, do të jetë nikoqir i profesionistëve të diasporës për një bashkëbisedim rreth angazhimit të diasporës në zhvillimin lokal dhe rreth ideve për strategji dhe projekte konkrete të kësaj komune për diasporën.

12:10 - 13:15 -- **Takim diskutues** me Kryetarin e Komunës së Kamenicës, z. Qëndron Kastrati.

13:30 - 14:30 -- **Vizitë në teren:** Mundësitë dhe sfidat për investime në nivelin lokal

14:30 - 15:30 -- Drekë

15:30 - 16:30 -- Arritja në Prishtinë